



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Ministrja e Ekonomisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.07/1 Mars 2019), nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-022 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike (GZ / Nr. 11 / 23 Dhjetor 2021), sipas nenit 6 të Rregullores (ME) Nr.10/2022 për vlerësimin e komformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar të kualifikuar si dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, nxjerr:

VENDIM

1.Themelohe Komisioni për vlerësimin e aplikantëve për Trupën e Konformitetit të Ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara, në përbërje të:

1.1. Ajshe Jashari	Ministria e Ekonomisë	Kryesuese;
1.2. Sami Shaqiri	Ministria e Ekonomisë	Anëtar;
1.3. Astrit Hulaj	Ministria e Punëve të Brendshme	Anëtar;
1.4. Visar Bajraktari	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	Anëtar;
1.5. Albina Jashanica	Agjencia Kosovare për Standardizim	Anëtare.

2.Komisioni sipas pikës 1 të këtij Vendimi ka për detyrë të vlerësoj përmbushjen e kushteve të aplikantëve për emërim të "Trupës për vlerësimin e konformitetit të Ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara të përcaktuar me Rregulloren (ME) Nr.10/2022 për vlerësimin e komformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar të kualifikuar.

3.Komisioni përgatit raport në bazë të vlerësimit të aplikacioneve, dhe rekomandon Ministren për emërim të Trupës për Vlerësim të Konformitetit për aktivitetet përkatëse sipas Rregullores (ME) Nr.10/2022 si dhe legjislacionin përkatës.

4.Anëtarët e Komisionit mund të përfitojnë kompensim shtesë në rastet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuar në nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë.

5. Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 27.04.2023



Vendimi i dërgohet:

- Komisionit;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit.